



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201700566/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:** Rekomandim për përfshirjen e fëmijëve me inicialet A.R dhe E.R në programin e mbrojtjes sociale/shërbimi i kujdestarisë

**Drejtuar:** Z. Armando Subashi  
Kryetari i Bashkisë

Znj. Alba Stefa  
Drejtore e Zyrës Rajonale të Shërbimit Sociale

Fier

**Për dijëni:** Z. Robert Zhezha  
Lagja "11 Janari"  
Rruga "Dino Kalenja", Ndërtesa 24, Hyrja 2

Fier

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e shtetasit Robert Zhezha, banues në lagjen "11 Janar", Rruga "Dino Kalenja", Ndërtesa 24, Hyrja 2, Fier.

Zoti Robert Zhezha është daja i dy fëmijëve me inicialet A.R dhe E.R të cilët jetojnë prej 6 muajsh në banesën e tij si rezultat i dhunës së ushtruar ndaj të ndjerës Zonjës Liljana Zhezha, e cila ka humbur jetën nga bashkëshorti i saj shtetasi Robert Rukaj. Shtetasi Rukaj është në hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë për shkak të kompetencës lëndore të veprës penale të ushtruar ndaj bashkëshortes së tij.

Shtetasi Robert Zhezha ankohet për mos përfshirjen e fëmijëve të motrës së tij në programet e mbrojtjes sociale konkretisht shërbimit të kujdestarisë si një e drejtë e parashikuar në nenin 54 të Kushtetutës ku thuhet se "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti".

Në zbatim të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe pikës 3, të nenit 6, të ligjit Nr. 8/2017 datë 23.2.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" thuhet se "Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatesinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;  
c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;  
ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; institucioni i Avokatit të Popullit realizoi hetimin e pavaruar ku i kërkoi Njësië për Mbrojtjen e Fëmijëve, (NJMF) Fier dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier shpjegimet përkatëse brenda fushës së veprimtarisë së tyre në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Nga vlersimi i dokumentacioneve të dërguara nga institucionet përkatëse të lartpërmenduar rezultoi se **Vendimi me Nr. 323 datë 17.03.2017** të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur caktimin e shtetasit Robert Zhezha si kujdestar ligjor të fëmijëve Alban Rukaj dhe Ejona Rukaj duke përcaktuar edhe të drejtat e palëve. *(Bashkëlidhur ju dërgojmë kopjë të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier)*

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 89 datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë” si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar** “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

#### **REKOMANDOJMË:**

Përfshirjen e fëmijëve Alban Rukaj dhe Ejona Rukaj në programet e mbrojtjes sociale, shërbimit të kujdestarisë ku me Vendimin **Nr. 323 datë 17.03.2017 të** Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur caktimin e shtetasit Robert Zhezha si kujdestar ligjor.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar** detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brënda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**